



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT

Rr. Eqrem Çabej, Nr.75, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383-38-242-747/242-748 • E-mail: fefs@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr.Prot: 317
Datë: 18/11/2024

RREGULLORE
PËR PROCESIN E STUDIMEVE PËR STUDENTËT SPORTISTË TË
KATEGORIZUAR NË FAKULTETIN E EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT

Prishtinë, Nëntor 2024

Në bazë të dispozitave të Statutit të Universitetit të Prishtinës UP, "Hasan Prishtina", Nenit 56 dhe Kompetencave Statutare të Këshillit të Fakultetit dhe Rregulloreve respektive në fuqi, Këshilli i Fakultetit të Edukimit Fizik dhe i Sportit (FEFS) në mbledhjen e mbajtur më datë: 20.11.2024, miraton;

RREGULLORE E BRENDSHME

PËR PROCESIN E STUDIMEVE PËR STUDENTËT SPORTISTË TË KATEGORIZUAR NË FAKULTETIN E EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

- 1) Me Rregulloren për procesin e studimeve të studentëve sportistë në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe i Sportit (FEFS) (në vazhdim Rregullorja) përcaktohen rregullat, kriteret dhe procedurat e procesit të studimeve të studentëve sportistë në FEFS.
- (2) Me termin "student sportist" nënkuptojmë: sportistin e kategorizuar në bazë të rregullores për kategorizimin e sportistëve dhe trajnerëve nr 14/2022 e hartuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS).
- (3) Në grupin e studentëve sportistë përfshihen: sportistët e kategorizuar, sportistët me nevoja të veçanta, sportistët e kategorizuar të shurdhër (në vazhdim tekstual student sportist i kategorizuar), që marrin pjesë në: Lojërat Olimpike dhe Paraolimpike, Kampionatet Botërore, Lojërat Evropiane, Kampionatet Evropiane, Lojërat Mesdhetare, Kampionatet Ballkanike, Kampionati i Kosovës, si dhe studentit sportist anëtar i ekipit kombëtar dhe atij universitar të UP-së, në përfaqësim ndërkombëtar dhe i ekipeve në Kampionatet e Kosovës.
- (4) Termat që përdoren në këtë Rregullore, të cilët kanë kuptim gjinor, pavarësisht nëse përdoren në formë mashkullore ose femërore, i referohen të dy gjinive.

Statusi i studentëve sportistë të kategorizuar

Neni 2

Statusin dhe të drejtat në përputhje me këtë Rregullore mund t'i fitojë dhe realizojë:

- (1) Studenti sportist i cili është kategorizuar sipas nenit 1, pika 2;
- (2) Studenti sportist me nevoja të veçanta sipas nenit 1, pika 3;
- (3) Studenti sportist anëtar i ekipit kombëtar apo atij universitar (UP-së) për përfaqësim ndërkombëtar dhe/ose ekipit universitar në Kampionatet e Kosovës, për të cilin dëshmohet përmes dokumentit zyrtar të lëshuara nga Federatat përkatëse dhe e Sporteve Universitare.

(4) Studenti sportist që ka statusin e një sportisti të kategorizuar sipas pikave 1, 2 dhe 3 të paragrafit 1 të këtij neni e dëshmon statusin me vendimin/rregulloren për kategorizimin e sportistit si dokument zyrtar nga MKRS.

(5) Studenti sportist që është anëtar i ekipeve kombëtare sportive të federatave përkatëse në Republikën e Kosovës, që janë anëtare të Komitetit Olimpik të Kosovës dhe të licencuar në MKRS e që kanë lëshuar dokumentin zyrtar përkitazi me statusin student sportist.

(6) Studenti sportist që është anëtar i ekipit kombëtar dhe atij universitar (UP-së) për përfaqësim ndërkombëtar ose ekipit në Kampionatet e Kosovës, sipas pikës 3 të paragrafit 1 të këtij neni, e dëshmon statusin me dokumentin zyrtar të lëshuar nga Federatat përkatëse dhe e Sporteve Universitare në Republikën e Kosovës.

Procedura për përcaktimin e statusit të studentit sportist të kategorizuar

Neni 3

(1) Statusi i studentit sportist të kategorizuar në FEFS, përcaktohet në fillim të vitit akademik dhe vlen për të njëjtin vit akademik, bazuar në vendimin për kategorizimin e studentëve sportistë të kategorizuar, të përcaktuar në neni 2, të kësaj Rregulloreje, ose bazuar në dëshminë e Federatës së Sporteve Universitare për studentët sportistë, anëtarë të ekipeve kombëtare, apo përfaqësueset e universitetit të një sporti të caktuar, të përcaktuar në pikën 3 të nenit 2 të kësaj Rregulloreje, si dhe në bazë të dëshmisë së Federatës së Sporteve Universitare të Kosovës për studentët sportistë që janë anëtarë të ekipit kombëtar apo atij universitar (UP-së) për përfaqësim ndërkombëtar ose ekipit universitar në Kampionatet e Kosovës, të përcaktuar në pikën 3, të nenit 2, të kësaj Rregulloreje.

(2) Për përcaktimin e statusit të studentit sportist, vendimi për kategorizimin e sportistit duhet të përmbajë periudhën e saktë të shfrytëzimit të të drejtave sipas këtij vendimi në momentin e regjistrimit të vitit akademik.

(3) Nëse një student sportist i cili i plotëson kushtet për kategorizim sipas kësaj Rregulloreje, e fiton këtë status me një vendim për kategorizim pas regjistrimit dhe gjatë vitit akademik, studentit sportist ka të drejtë të kërkojë përcaktimin e këtij statusi dhe kushteve të veçanta të studimit sipas kësaj Rregulloreje edhe më vonë, gjatë vitit akademik.

(4) Statusi i përcaktuar i studentit sportist të kategorizuar dhe i studentit sportist vlen për vitin aktual akademik, pra për periudhën nga 15 shtatori deri më 14 shtator të vitit të ardhshëm.

Kohëzgjatja e procesit të studimeve për studentët sportistë të kategorizuar

Neni 4

- (1) Studenti sportist i kategorizuar ka të drejtë të përfundojë një vit akademik brenda një periudhe prej dy vitesh akademike.
- (2) E drejta për të shtyrë një vit studimi mund të ushtrohet vetëm për arsye të justifikuara dhe lejohet vetëm dy herë gjatë gjithë periudhës së studimit.

Kushtet e veçanta dhe mbështetja për studentin sportist të kategorizuar

Neni 5

- (1) Me vendimin për statusin e studentit sportist të kategorizuar përcaktohen kushtet e veçanta dhe mbështetja për studentët sportistë. Dokumentacioni i nevojshëm për përcaktimin e statusit dhe realizimin e të drejtave të studentit sportist përfshin: ID kartelën, vendimin mbi kategorizimin nga federata kombëtare sportive, si dhe kalendarin e aktiviteteve të vulosur nga federata kombëtare përkatëse.
- (2) Vendimi për statusin e studentit sportist të kategorizuar duhet të përfshijë:

- Kandidati/sportist aplikant për t'u pranuar në FEFS, në vitin e parë akademik dhe që është si sportist i kategorizuar me dëshmi zyrtare nga institucioni përkatës, në provimin pranues, do të ketë deri në 10 pikë avantazh, bazuar në Shtojcën I, nga pikët e përgjithshme që mund t'i marr në provimin pranues.
- Të drejtën e studentit sportist të kategorizuar për të munguar nga mësimi, detyrohet për të njoftuar për mungesën e justifikuar, menaxhmentin e FEFS-Dekanin (p.sh. përgatitje dhe pjesëmarrje në gara ndërkombëtare) e rregulluar në Shtojcën II.
- Mundësinë për studentin sportist të kategorizuar që të nënshtrohet në kolokviume dhe provime jashtë afateve të rregullta, (para ose pas afatit të provimit) nga mungesa dhe mos prezenca e tij, bëhet në marrëveshje me profesorin e lëndës dhe prodekanin për mësim, në rast të arsyeve të dokumentuara dhe të justifikuara, duke siguruar transparencë gjatë zhvillimit të provimeve dhe kolokviumeve.

Mobilitetet për student sportistë të kategorizuar

Neni 6

Kushtet për mobilitetin e studentit sportist, i cili, për të vazhduar karrierën sportive, ndryshon vendin e studimit, do të rregullohen me një marrëveshje të veçantë ose akt tjetër midis institucioneve të arsimit të lartë.

Detyrimet e studentit sportist të kategorizuar

Neni 7

1. Studentët sportistë të kategorizuar janë të obliguar të përfaqësojnë FEFS në garat sportive zyrtare studentore nëse sportisti është i ftuar apo pjesë e programit të Federatës së Sporteve Universitare të Kosovës, Shoqatës Evropiane të Sportit Universitar (EUSA) dhe Federatës Botërore të Sportit Universitar (FISU), si dhe në aktivitete promovuese, humanitare dhe të ngjashme të FEFS-UP, ku studiojnë dhe përfitojnë të drejta të veçanta si studentë sportistë.
2. Në rast të mos përmbushjes së obligimeve të specifikuara në paragrafin 1 të këtij neni, studentit sportist i kategorizuar e humb statusin.

Ndërprerja e karrierës sportive

Neni 8

1. Nëse një student sportist ndërpret karrierën sportive dhe e humb statusin e sportistit sipas nenit 2, të kësaj Rregulloreje, ai është i detyruar të njoftojë FEFS-in për vendimin e tij për ndërprerjen e karrierës sportive.
2. Humbja e statusit të studentit sportist nënkupton përfundimin e zbatimit të kushteve dhe mbështetjes së veçantë të përcaktuara në këtë Rregullore.

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Neni 9

1. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje mund të bëhen me propozimin e Dekanit të FEFS, në Këshillin e Fakultetit.
2. Për të drejtat dhe detyrimet e studentëve sportistë të kategorizuar që nuk janë rregulluar me këtë Rregullore, zbatohen dispozitat e ligjeve dhe akteve të përgjithshme të institucioneve në të cilat sportisti është regjistruar.

Hyrja në fuqi

Neni 10

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli i Fakultetit të Edukimit Fizik dhe i Sportit.

Rregullore Nr.03/Rr-268
20.11.2024



Dekani i Fakultetit

Prof. Asst. Florian Miftari

Shtojca I

Medalja e artë Olimpike.....	50 pikë
Medalja e argjendtë	45 pikë
Medalja e bronzhtë	40 pikë
Kampionati Botëror medalja e artë	50 pikë
Kampionati Botëror medalja e argjendtë	45 pikë
Kampionati Botëror medalja e bronzhtë	40 pikë
Kampionati Evropian medalja e artë	40 pikë
Kampionati Evropian medalja e argjendtë	35 pikë
Kampionati Evropian medalja e bronzhtë	30 pikë
Lojërat mesdhetare medalja e artë	35 pikë
Lojërat mesdhetare medalja e argjendtë	30 pikë
Lojërat mesdhetare medalja e bronzhtë	25 pikë
Kampionatet ballkanike medalja e artë.....	30 pikë
Kampionatet ballkanike medalja e argjendtë	25 pikë
Kampionatet ballkanike medalja e bronzhtë	20 pikë
Përfaqësues të ekipeve kombëtare të secilit sport të licencuar nga institucionet e Republikës së Kosovës	20 pikë
Anëtar i ekipeve kampione të sporteve më të popullarizuara në sejcilin sport në Kosovë nënkuptojmë: sportistin e kategorizuar në bazë të rregullores për kategorizimin e sportistëve dhe trajnerëve nr 14/2022 e hartuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS). në nivelet më të larta garuese në Republikën e Kosovës.....	10 pikë

Shtojca II

Medalja e artë Olimpike	75%
Medalja e argjendtë olimpke	75%
Medalja e bronzë olimpke	75%
Kampionati Botëror medalja e artë.....	75%
Kampionati Botëror medalja e argjendtë.....	75%
Kampionati Botëror medalja e bronzë	75%
Kampionati Evropian medalja e artë	75%
Kampionati Evropian medalja e argjendtë	75%
Kampionati Evropian medalja e bronzë	75%
Lojërat mesdhetare medalja e artë	60%
Lojërat mesdhetare medalja e argjendtë.....	60%
Lojërat mesdhetare medalja e bronzë.....	60%
Kampionatet ballkanike medalja e artë	50%
Kampionatet ballkanike medalja e argjendtë	50%
Kampionatet ballkanike medalja e bronzë	50%
Përfaqësues të ekipeve kombëtare të secilit sport të licencuar nga institucionet e Republikës së Kosovës.....	40%
Anëtar i ekipeve kampione të sporteve më të popullarizuara në sejcilin sport në Kosovë nënkuptojmë: sportistin e kategorizuar në bazë të rregullores për kategorizimin e sportistëve dhe trajnerëve nr 14/2022 e hartuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS). në nivelet më të larta garuese në Republikën e Kosovës.....	30%